

---

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



---

Implemented  
by the Council of Europe

**Program i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës  
“BE / KiE Mbështetje për Efikasitetin e Drejtësisë – SEJ”**

**Analizë e rezultateve të sondazhit mbi nivelin e kënaqshmërisë së  
përdoruesve në 10 gjykata të Shqipërisë**

**Marco Fabri**

**Instituti Kërkimor për Sistemet Gjyqësore  
Këshilli Kërkimor Kombëtar i Italisë (IRSIG-CNR)  
Bolonjë, Itali**

**2016**

**Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet e autorit dhe jo detyrimisht ato të Këshillit të Evropës apo të Bashkimit Evropian.**

**Sondazhet për Gjykatat u administruan nga IDRA shpk, Tirana, Shqipëri. IDRA zhvilloi gjithashtu përpunimin e të dhënave të sondazheve. Analiza e të dhënave dhe interpretimi i tyre u realizuan nga autori i këtij raporti.**

**Me poshte vijon analiza per Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan**

## Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

Nga përdoruesit e intervistuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, 62% qenë meshkuj dhe 38% qenë femra. 37% qenë nën moshën 45 vjeç, 53% qenë mbi këtë moshë. 67% kishin përvojë të mëparshme me këtë gjykatë, 57% edhe me një gjykatë tjetër.

53% e të intervistuarve qenë palë në një çështje, 26% të afërm (familjarë) të njërit prej palëve, 8% dëshmitarë ose ekspertë. 83% ndodheshin në gjykatë për një proces civil, 15% për një proces penal.

**Aksesi në gjykatë** është matur me 5 pyetje. Gjykata është vlerësuar mjaft lart (shkalla e përdorur është 1 deri në 7) për "infrastrukturat e sallës së gjyqit" (5,1), "shenjat treguese brenda gjykatës" (5,0) dhe "kushtet e pritjes në gjykatë" (4,9). Diçka më pak është vlerësuar "vajtja në gjykatë" (4,0). **Shumë ulët** është vlerësuar "**aksesi për personat me aftësi të kufizuar**" (2,1).

**Funksionimi i gjykatës** është matur me 5 pyetje. Gjykata është vlerësuar mjaft lart (5,8) për "qartësinë e fletëthirrjeve dhe njoftimeve", "përpikërinë e orarit të seancave dëgjimore pasi është planifikuar në kalendar" (5,5) dhe "qëndrimin dhe sjelljes" (5,2). Vlerësime mjaft të mira kanë të bëjnë me "kompetencën e personelit të gjykatës" (5,1); "hapësirën kohore midis fletëthirrjes së gjykatës dhe seancës dëgjimore" (4,8).

**Performanca e gjyqtarëve** është matur me 8 pyetje. Gjykata është vlerësuar mjaft lart për "kohën që i jepet palës" (5,6), "solemnitetin e seancës" (5,4), disi më pak për "qëndrimin dhe sjelljen" (4,9), "paanshmërinë" (4,3), "kohën që kalon nga seanca deri në dhënien e vendimit të gjykatës" (4,0), "qartësinë e vendimit të gjykatës" (4,7), "kohën që kalon nga dhënia e vendimit deri në zbardhjen e tij" (3,8). **Pika më pak e vlerësuar** ka të bëjë me "**qartësinë e gjuhës së gjyqtarëve**", që është vlerësuar me vetëm 2,6 nga 7.

Dy pyetje kishin të bënin me **prokurorët**. "Gjuha" ka vlerësim në mes të shkallës 3,7. "Qëndrimi dhe sjellja" kanë marrë një vlerësim disi më të ulët (3,5).

**Aksesi në informacion** është matur përmes "lehtësisë së gjetjes së informacionit për të drejtat e përdoruesit", që ka marrë vlerësimin 3,7, dhe "qartësisë së informacionit" që jep gjykata, që është vlerësuar me 2,9.

**Sekretaria** përdoret kryesisht për "tërheqje dokumentesh" (66%), dhe marrje "informacioni për vendimet e gjykatës" (75%). 98% e këtij informacioni merret personalisht nga sekretaria dhe cilësia e këtij informacioni është vlerësuar mirë (5,1).

**Perceptimi i përgjithshëm i funksionimit të drejtësisë** në këtë gjykatë është matur me anë të 4 pyetjeve. "Organizimi i funksionimit të gjykatës" është mjaft i qartë (4,6), "kostoja e aksesit në sistem" (pa përfshirë tarifën për shërbimet ligjore) nuk konsiderohet e shtrenjtë (5,2), besimi në sistemin e drejtësisë (3,7) dhe shpejtësia e trajtimit të çështjes (2,9) kanë vlerësimin më të ulët.

45% e përdoruesve të gjykatës mendojnë se burimet materiale në dispozicion të gjykatave janë të mjaftueshme, ndërsa 22% nuk mendojnë se janë të mjaftueshme.

**Avokatët** e intervistuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan kanë mesatarisht më shumë se 7 vjet ushtrim të profesionit. 30% punojnë në një zyrë avokatie, 70% janë të vetëpunësuar.

Pyetësi mat perceptimin e avokatëve për **marrëdhëniet me gjykatën** me anë të 13 dimensioneve/pyetjeve.

Nga niveli më i lartë i kënaqshmërisë të ai më i ulët, vlerësimet mesatare të avokatëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan janë si më poshtë (vini re, ju lutemi, se shkalla është nga 1 deri në 7):

Orientimi brenda gjykatës	6,5
Komunikimi me sekretarinë	6,5
Sjellja dhe qëndrimi i personelit administrativ	6,2
Përgjegjësi dhe organizim i qartë	6,1
Cilësia e informimit	6,1
Disponibiliteti i personelit administrativ	6,1
Qartësia e informacionit të dhënë	6,0
Kompetenca e personelit administrativ	5,9
Konsultimi i lehtë dhe praktik i dosjeve	5,8
Kostot/tarifat e aksesit në sistemin e drejtësisë	5,6
Aksesi në jurisprudencë	5,5
Aksesi dhe dobia e faqes në internet të gjykatës	4,8
Menaxhimi i kompjuterizuar i proceseve	4,7

Të gjitha dimensionet janë vlerësuar edhe sipas rëndësisë, që është gjithmonë shumë afër maksimumit të shkallës së vlerësimit (7,0).

Avokatëve iu bënë pyetje edhe për nivelin e kënaqshmërisë lidhur me **përgatitjen dhe zhvillimin e seancave gjyqësore** me anë të 10 pyetjeve, që morën vlerësimin në vijim:

Sjellja dhe qëndrimi i gjyqtarëve	6,0
Përpikëria kohore e seancave dëgjimore	5,8
Organizimi dhe ecuria e seancave dëgjimore	5,7
Paanshmëria e gjyqtarit gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore	5,7
Sjellja dhe qëndrimi i prokurorëve	5,6
Kompetenca e gjyqtarëve	5,5
Kushtet e takimit me klientët	5,5
Performanca e prokurorëve	5,5
Përgjegjësi dhe organizim i qartë	5,4
Solemniteti i seancave	5,4
Pajisjet, mobilimi i sallës së gjyqit	3,6

Fusha e tretë me interes që është ekzaminuar me pyetësoin që perceptimi që kanë avokatët për **gjyqtarët dhe procesin e vendimmarrjes**, që është matur me anë të kriterëve të mëposhtme dhe që kanë marrë këto vlerësime:

Trajtim i shpejtë i çështjeve penale	5,8
Qartësia e vendimeve	5,5
Pavarësia e gjyqtarëve	5,4
Vendime lehtësisht të zbatueshme	4,9
Trajtim i shpejtë i çështjeve civile	4,6
Ekzekutimi i vendimeve nga përmbaruesit	4,3
Trajtim i shpejtë i çështjeve administrative	nuk ka

50% e avokatëve të intervistuar kishin perceptimin se funksionimi i gjykatës është përmirësuar gjatë 5 viteve të fundit, 27% se nuk ka ndryshuar, 3% se është përkeqësuar.

83% mendojnë se ngarkesa e punës të gjykatës është rritur më shpejt se mundësitë e saj.

Në fund, më shumë se 55% e avokatëve mendojnë se burimet nuk janë të mjaftueshme. kjo përqindje arrin 70% për perceptimin në lidhje me mungesën e gjyqtarëve.